

BIBLIOTEKA :
SHTETIT

81H-87

N770.



GURI MICINOTI

Njerëzit që
shpejtojnë
vitet
roman





GURI MICINOTI ka lindur në Voskopojë të rrethit të Korçës më 15 shtator 1936. Ai punon shofer në parkun e mallrave «Raqi Themeli» në Korçë.

Tregimet e para ka filluar t'i shkruajë nga viti 1959. Po këtë vit ka fituar çmim të dytë në konkursin e shpallur për nder të 25-vjetorit të Çlirimit me novelën «Jurkani».

Ai gjithashtu është autor i novelës «Në rrugën me akull» dhe i romaneve «Nëntë ballë» dhe «Brigada e shtatë».

«Njerëzit që shpejtojnë vitet» është romani i tij i tretë.

814-21

M 70

GURI MIÇINOTI

NJERËZIT QË SHPEJTOJNË VITET

Roman



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Redaktore Natasha Dulaku
Kopertina nga Svetllana Strazimiri

Tirazhi 8.000 kopje

Format 78x109/32

Stash: 2204-72

Shtyp. Drejtoria Qendrore Poligrafike
Shtypshkronja «8 NËNTORI» — Tiranë, 1975

Si janë kujtimet! Të mbërthejnë e të çojnë larg, në vite të shkuara, të papërsëritshme e të ngjallin para sysh tablotë e punës plot vetëmohim.

Duke vështruar këto fotografi të zverdhura nga koha, mendja më shkon në ato vite të lavdishme, mbushur gjithë punë e sakrifica, gjithë mund e djersë, gjithë emociione e gëzime. Pse ta fsheh? Duke i vështruar këto fotografi, më kap një mallëngjim i ligjshëm e përpiqem të dalloj një e nga një të gjithë shokët e vjetër të punës. Ja, ky nga e djathta ime është sekretari i partisë, ky tjetri motoristi i heshtur, ky nga e majta shoferi i qeshur e i vëmendshëm që na shkrinte me qyfyret e tij.

Ishin vitet e para të ndërtimit e të forcimit të pushtetit popullor. Duke vështruar rrugët e shkatërruara nga lufta, ndërtesat e rrënuara nga bombardimet, gjithë ato ura të hedhura në erë nga minat, fëmijët e heshtur, të hequr nga fytyra, të verdhë nga lëkura, me sy të futur në zgavrat, të kapte një trishtim që dashje pa dashje të fuste në gjak hutimin. Po ne nuk e lëshuam veten e ditëm t'u bënim ballë edhe urisë, edhe shkatërrimit. Me porosinë e partisë, me fjalët e saj të flakta, gjithë besim në të ardhshmen e lumtur, i hymë punës me gjoks siç i hymë luftës, e ia dolëm mbanë. Vështirë ishte, po nuk u tërhoqëm nga vështirësitë.

Ama të mos lëvdohemi e të mos i biem gjoksit si ndonjë kapadai. U lodhëm dhe çfarë të lodhuri se. Po nuk psherëtimë një herë dhe nuk na u thye zemra. Në dushin e djersëve tona ne gjetëm freski e muskujt, megjithëse të mpirë, nuk ngrinë e nuk na lanë në baltë. Një forcë të tillë të mahnitshme, të ngjashme me forcën e partizanëve që hidheshin në sulm gjatë luftës — këtu nuk ka asnjë sekret

— e ngjall vetëm ideali dhe dashuria që kemi për popullin, për partinë.

«...Nga makina që troshitet ngrihem me vrull në spon-din e parë dhe vështrimin e hedh nga qyteti. Ja ku duket ai, i lashtë dhe i heshtur, si një sfinks legjendar që nuk kanë mundur ta mposhtin ordhitë e luftës. Dielli i kuq po perëndon e, duke lënë qytetin, e lyen me bojën e bakërt. Një mallëngjim më lidhet rreth fytyrës së sytë më mbushen me lotë. Mezi i mbaj lotët duke vështruar vrapin e çmendur që merr qyteti për të më pushtuar mua.

Vjeshta e ftohtë përgatitet t'i marrë rraqet e saj të mbushura me zukatjen e fletëve të djegura që mbushin rrugët e copëtuara nga plagët e luftës. Nga maja e malit fryn era e ftohtë që t'i pret faqet si brisk. Një plak, dikur kur ishim bazë në shtëpinë e tij, më pati thënë: «Thëllimi i ftohtë i erës në vjeshtën e vonshme, ta dish, o bir, është boria e dimrit që vjen. Dimri, o bir, është shumë kapadai, sepse kërkon të duket, prandaj dërgon kështu lajmëtarë të ftohtë!» Nuk di pse m'u kujtuan fjalët e atij plaku të dashur e të qeshur që na kishte hapur zemrën së bashku me portën e madhe të konakut të tij, apo mos vallë ngaqë të ftohtët e hidhur, i zbritur nga mali, i ishte qepur shkatërrimit të gjithanshëm.

Vjeshta e mbushur gjithë ngjyra e melankoli më ka pëlqyer gjithmonë.

Plepat e rrugës, të heshtur, mbushur me lëmyshk, tani ishin nxirë nga plagët që kishin marrë në trupin e tyre. Copërat e metalit të bombave dukeshin si sëpata, bishti i të cilave ka ikur e ka fluturuar duke lënë në trungjet e pemëve mykën si një thikë të ngulur në kurriz...»

Me të tilla kujtime mbushem kur vështroj fotografinë e parë. Në fotografinë e dytë është një barrakë që nuk vlen sot për asgjë. Barraka është e prishur e ndonjë mund të thotë ajo karakterin nuk i ka hyrë në punë kurrkujt. Por, kjo barrakë e vjetër, e shkatërruar, që nuk ta mbush syrin, kjo barrakë e anuar sikur do të rrëzohet nga e majta e do të thyejë koskat e saj, kjo barrakë e nxirë, ka qenë ndërtesa e parë ku është ngritur ndërmarra jonë në fi-

llim. Në ato vite kur unë u emërova drejtor, kjo barrakë ka qenë oficinë dhe park së bashku.

Më kujtohet se si ishte zbukuruar kjo barrakë ditën e 1 Majit të parë që unë festoja në atë ndërmarrje. Ja ku duket edhe flamuri i vogël që ishte ngritur në shtizë. Në vështrimin e parë të duket sikur nuk ka asgjë të veçantë ky flamur. Po ta vështrosh me vëmendje fotografinë, të duket se nuk është ashtu. Flamuri nuk vlente thjesht si zbukurim, ai ishte vulosje e dëshirës së popullit që ndërmarrja të ishte e shtetit, e tij. Këtu pas flamurit ishin mbledhur të gjithë punëtorët që atëherë nuk ishin shumë. Pastaj prapa tyre ishte vënë një gramafon me pllakën e internacionales që nuk dihej se ku e kishin gjetur punëtorët atë ditë.

Ndërmarrja ku isha emëruar ishte pakëz larg nga qyteti. Dikur në këtë vend, në Luftën e Parë Botërore ishin zhvilluar beteja të ashpra.

Për këto beteja fliste me pasion, në urban një burrë i gjatë me kokë të madhe me një cullufe si të ishte një malësor i vërtetë. Ai kishte një buzëqeshje të ëmbël, fisnike e një palë dhëmbë të vegjël si rruaza. Quhej, Asllan dhe më hyri shpejt në zemër.

Në sheshin para oficinës urbani qëndroi. Ishte një autobus i madh që ngjasonte me një furgon të gjerë e të habitshëm që fati nuk dihej se si e kishte ngritur dhe e kishte vendosur mbi katër rrota duke e bërë autobus. Kjo për mua mbeti shumë kohë enigmë, megjithëse duhet të pranohet se mendjen e lodha shumë. Xhamet e vendosura në parvazet e autobusit të çuditshëm lëviznin lirisht e zhurma që krijohej prej tyre e mbushte barkun e tij të gjerë me një mjaullitje që të ngrinte nervat. Rruga që shtrihej përpara, e mbushur me gropa, e lëkundte këtë krijesë të frikshme sa andej-këtej e këto lëkundje të trullosnin e të merrnin frymën. Por, me gjithë këto vështirësi, autobusi i llahtarshëm e bënte punën që ç'ke me të për mrekulli e punëtorët e oficinës ishin shumë të kënaqur prej punës së tij. I heshtur e madhështor, në sheshin e madh me kalldrëm të oficinës, ky autobus ngjasonte me një qen bulldok që bën rojë i qetë në punën e tij. Sa binte çanga e mbarimit

të punës me atë zhurmën e saj therëse si një kakaritje këndesi, autobusi çohet nga gjumi e ndizej me vështirësi. Boria e tij si një lehje e ngjirur i ftonte miqtë e vjetër të hipnin në të e ashtu, gjithë kërcëllimë, e fillonte vrapin mes rrugës së mbushur me gropa. Këtë rrugë «bulldoku» e bënte shumë herë në ditë e unë, duke filluar prej asaj dite, do të isha një nga miqtë e tij të shumtë për t'u kolovitur...

Pozicioni i ndërmarrjes nuk më pëlqeu aspak. Ajo ngjasonte me një kulaçe katrore, ndarë më dysh nga rruga që shkonte mes për mes copërave të ndara. Njëra prej tyre kalonte poshtë e tjetra ngjitej lart saj duke e mbështjellë rrugën në mes. Makinat e riparuar nga ofiçina e kishin të vështirë të dilnin në rrugën kryesore e shoferët e tyre i hapnin sytë katër duke mbajtur gati këmbën në pedalin e frenave. Një ndërtim i tillë, sigurisht, nuk e nderonte autorin e, për më shumë, mallëkimet e shoferëve që u drejtoheshin njerëzve të kapur në befasi në rrugën e gjerë, u drejtoheshin edhe atyre si me spond. Ishte një pozicion i vështirë dhe qarkullimi i mjeteve do të haste në pengesa. Për këtë u binda porsa frenat e një makine vërshtëlljen me të madhe e shoferi i nevrikosur më shau nga dritarja e gjerë.

— Ku i ke sytë? Në...

Unë qesha e, duke tundur kokën, u futa në korridorin e gjerë, të mbushur me një errësi të frikshme e të qetë. Dola jashtë me frikën se mos gabimisht kisha hyrë në ndonjë magazinë. Për këtë pyeta një xhenerik me rroba të përlyera me vaj.

I humbur në mendime, dukej qartë që xheneriku nuk më kishte vështuar e tani habitej se si isha gjendur përpara tij sikur të kishte dalë nga toka.

— Çarë thatë?!

— Ju pyeta për zyrat, më falni, po kërkohet zyrat e këntushme, ndoshta jam gabuar e nuk i kam rënë në të shtegut.

— Ah!... Zyrat! Duket se je hutuar më shumë se unë, i dashur buçko.

U shtanga nga përgjigjja e tij e duhet të pranoj se

një valë zemërimi po më ngjitej në gjoks. Kjo ishte dhe arsyeja që ia mbërtheva sytë mirë siluetës së tij që u zhduk nga sytë. Por le të zhdukej, unë nuk kisha për ta harruar atë fytyrë dhe do të vinte dita që ai do të ma shpaguante pagëzimin «buçko» që sapo ma kishte bërë.

Më dukej sikur fati karshi meje ishte treguar shumë mosmirënjohës duke më dënuar në këtë oficinë të heshur, të vjetër, mbushur me lagështirë dhe njerëz të krisur, që nuk e kanë për gjë të të pagëzojnë në çast me lloj-lloj nofkash. Korridorin zgjatej para meje e më dukej sikur fundi i tij i ngushtë bashkohej me një pikë. I gjatë dhe i heshur ky korridor. Duke qarë, u hap një derë e madhe që mbushi gjithë korridorin me ulërimën e saj. Sëmundja ishte e qartë. Mendeshat e derës nuk ishin të vajtura e kuja që nxirrte fërkimi i hekurit të ngrinte nervat e të fuste mornica në trup. Si dukej kjo shaka i pëlqente ndonjërit prej nëpunësve që shpeshherë me shkak e pa shkak e hapte këtë derë qaramane. Përveç kësaj dere në korridorin e gjatë ndiheshin nganjëherë zukatja e një makine shkrimi dhe trokitja e shkronjave në rulin e saj. Kjo bëhej rrallë dhe dukej qartë se ai që e punonte makinën e shkrimit nuk kishte kohë të gjatë me të.

Ndërtesa e oficinës ishte pesëmbëdhjetë hapa larg zyrave. Distanca e shkurtër bënte që gjithë zhurma bubulluese e tornos së vjetër gjermane të trondiste të gjithë territorin e oborrit, duke përfshirë edhe barrakën e zyrave. Kjo të ngjallte frikë e mendja të shkonte te fenomenet e tmerrshme të natyrës; punëtorëve nuk u bënte përshtypje dhe ata, si të thuash, ishin mësuar me këtë gjendje troshitëse. Vetëm se, sa herë fillonte nga puna ajo torno e habitshme, llogaritari i ndërmarrjes, një burrë me natyrë aspak të qetë, me sytë e zhdërvjellët e shumë nevrinë, hapte dritaren e pyeste pa të keq kalimtarët e huaj:

«— Më falni, mos e ndiet dhe ju tërmetin që sapo ra?

— Çfarë tërmeti, kush tha se ka rënë tërmet?! — ia priste i huaji, i cili e vështronte me habi dhe plot interes fytyrën e tij të verdhë me ato syzet e lidhura me spango në lllapat e veshit.

— Po tani u drodh toka, more i bekuar? — ia priste me lotë në sy llogaritari që tashmë e kishte humbur durimin dhe ishte bërë më nevrrik se bashkëbiseduesi.

— Unë nuk kam ndier gjë dhe të lutem më lër të qetë në punët e mia.»

Ditën e parë kështu ndodhi dhe me mua. Llogaritari, i frikësuar, hapi dritaren e më pyeti:

— Mos e ndiet tërmetin, tani sapo filloi?!

Duhet të pranoj se nga punët e makinave të rënda nuk merrja erë dhe isha, siç shprehet populli, tapë topi për kësi punësh. Pyetja e tij më hutoi për një çast. Por mendjen nuk e kisha humbur, prandaj dhe përgjigjen ia dhashë në vend.

— Më duket se keni të drejtë, edhe unë e ndjeva dridhjen e tokës.

— Shumë mirë, i dashur zotni, oh, më falni... shok... kanë ardhur kohë të reja e gjuhët janë mësuar me doket e vjetra, kështu e kemi ne, pleqtë, sa të mësohemi. Kështu që thua ti, i dashur shok, pas kaq muajsh mezi gjeta një njeri që të më kuptonte e të më jepte të drejtë.

Koka e tij u zhduk përpara se unë të kisha mundësi të vëzhgoja ndërtimin e saj. Po syzet e lidhura me spango prapa veshit nuk më shqiteshin nga mendja. Kërcëllitja e dritares më ndoqi si një re pluhuri pas. Kështu, duke qeshur me veten time, vazhdova rrugën për të hyrë në oficinë. Pas derës së vogël prej dërrase, përlyer me njolla vaji e grasoje, shtrihej gjysmëerrësira e mbushur me zhurma të ndryshme e gjithë mister. Çfarë do të fshihe-shin vallë prapa asaj errësire të mahnitshme e të frikshme që ishte ndarë nga kufiri i derës së ndotur me vaj e graso? Cilat do të ishin ato genie që e mbushnin ambientin me atë dridhmë të habitshme, me ata zëra të mprehtë që nuk pushonin për asnjë çast? Sigurisht që lubi nuk do të ishin, as luanë ose tigra, po hajde e meri vesh se ç'ishin ato genie.

Një frikë më pushtoi për një çast. Vallë si do t'i drejtoja unë punët e kësaj oficine kur nuk dija asgjë. «Zanati», thotë populli, «ka një torbë me hallate.» Unë nuk